



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilmenjo/Prodato Received/Delivery	09-10-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHCK	6427	2023	1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1105/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1105/2023 të datës 23.08.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit, Komunës së Pejës në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.1105/2023 e datës 23.08.2023, e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Nëpunësi civil i punësuar në pozitën e punës “Shef i Sektorit për Kulturë” në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Pejës, sipas Akt Emërimit të datës 04.01.2012, me datë 23.08.2023 me numër protokoli 5780/2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për trajtim selektiv, jo i barabartë fyerje dhe denigrim individual dhe kolektiv të stafit, marrje të kompetencave, pengim i realizimit të detyrave të punës, mos respektim i hierarkisë, tejkalim të kompetencave dhe mos respektim i kodit të etikes nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Pejës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës, ndërsa Këshilli më datë 31.08.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Pejës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokolli 5780/2023 të datës 23.08.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 01.06.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 06.06.2023; E-mailin e datës 06.06.2023; E-mail e datës 28.03.2023; Raport nga konsullta me nr. regjistri 344; Udhëzim për konsultim me nr. regjistri 1528; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 15.06.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.07.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.07.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 20.06.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.07.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.07.2023; E-mailin e datës 15.05.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 18.04.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 21.03.2023; Procesverbal i takimit të rregullt të stafit të DKRS të datës 06.04.2023; Procesverbal i takimit të rregullt të stafit të DKRS të datës 06.06.2023; Lista e pjesëmarrësve në takim të rregullt e DKRS i datës 30.05.2023; E-mail i datës 22.01.2021; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 01.08.2023; E-mail i datës 10.05.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 10.05.2023; ID e [redacted] me nr. i kartelës KPE-0053; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 15.08.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 15.08.2023; E-mail nga Inspektorati i punës për [redacted] i datës 14.08.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 14.08.2023; E-mail nga [redacted] për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 23.08.2023; E-mail nga [redacted] për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 23.08.2023; E-mail nga [redacted] për ankesa.kpmshck@rks-gov.net i datës 23.08.2023; E-mail i datës 22.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 31.08.2023; Akt Emërim i [redacted] i datës 04.01.2012; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 27.09.2012; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm i ulët dhe profesional i [redacted] i datës 27.01.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 24.07.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 24.07.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] etj. i datës 24.07.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit [redacted] është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës konkretisht Aktin e Emërimit të datës 04.01.2012, rezulton se ankuesi është i punësuar i punësuar në pozitën e punës "Shefi i Sektorit për Kulturë" në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Pejës.

Ankuesi, me datë 23.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për trajtim selektiv, jo i barabartë fyerje dhe denigrim individual dhe kolektiv të stafit, marrje të kompetencave, pengim i realizimit të detyrave të punës, mos respektim i hierarkisë, tejkalim të kompetencave dhe mos respektim i kodit të etikes nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Pejës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës të dërguara nga organi i punësimi konkretisht Komuna e Pejës lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, nuk ka gjetur ndonjë shkresë apo komunikim zyrtar me të cilin ankuesit i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Pejës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...Kolegji vlerëson se ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i tij lidhur me marrëdhënien e tij të punës, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.1105/2023 e datës 23.08.2023, e parashtruar nga ankuesi Aver Husaj është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1105/2023

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHC-së.